

EPPC Kosovo në kuadër të zgjerimit të aktiviteteve të saj, kërkon një **Këshilltar/e të Burimeve Njerëzore (HR Advisor)**.

**Përgjegjësitë Kryesore:**

- Ofron konsulencë për klientët në lidhje me trajnimet, punësim, paketat financiare dhe shërbimet tjera;
- Njeh dhe kupton mirë industrinë ku klienti operon, nevojat dhe kërkesat e tij, si dhe ambientin dhe kulturën e punës;
- Viziton klientët me qëllim ndërtimi, zhvillimi dhe ruajtjen e marrëdhënieve mes palëve;
- Ofron mbështetje operacionale në të gjitha aspektet e promovimit të shërbimeve të kompanisë përmes kanaleve të ndryshme;
- Ofron ekspertizë teknike në planifikimin, hartimin dhe zbatimin e projekteve dhe iniciativave kryesore të kompanisë;
- Pjesëmarrje në procesin e marrëdhënieve të punës në lidhje me Rekrutimin dhe Përzgjedhjen e kandidatëve për punësim;
- Identifikon mundësitë për të përmirësuar dhe/ose në ofrimin e shërbimeve në vazhdimësi.

**Kërkesat për këtë pozicion janë:**

- Diplomë Universitare (E preferuar në Burime Njerëzore, Administrim Biznesi, Menaxhment, Juridik ose Shkenca Sociale);
- Eksperiencë pune së paku dy (2) vite, përbën avantazh në Burime Njerëzore, Shitje B2B dhe/ose këshillimi i bizneseve;
- Aftësi të shkëlqyera organizimi, komunikimi dhe aftësi negociuese;
- Aftësi analitike dhe udhëheqëse, dhe aftësi për përcaktimin e prioriteteve;
- Njohuri të avancuar të paketës Microsoft Office, dhe të përdorimit të Rrjeteve Sociale;
- Njohuri shumë të mira të gjuhës Angleze;
- Të posedojë leje drejtimi, kategoria B.

**Të dhënat:**

<b>Pozicioni:</b>	Këshilltar/e i/e Burimeve Njerëzore (HR Advisor);
<b>Vendndodhja:</b>	Prishtinë;
<b>Orari:</b>	40 orë në javë;
<b>Kontrata:</b>	Sipas Ligjit të Punës;
<b>Aplikimet mbyllen:</b>	11.02.2018.

**Si të aplikoni:**

Për të aplikuar për këtë mundësi punësimi, ju lutemi dërgoni CV-në tuaj dhe dokumentet e tjera shoqëruese duke **përmendur pozicionin për të cilin aplikoni** në adresën e e-mail<sup>it</sup>:

[kosovo@eppc.al](mailto:kosovo@eppc.al)

Ju do të kontaktoheni vetëm në qoftë se CV-ja juaj dhe dokumentet shoqëruese do të kualifikohen.  
Tek ne CV-ja juaj është e sigurt dhe trajtohet në konfidencialitet të plotë.